



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planuar / Doretur / Punësimi / Pradati / Received / Delivered	08.12.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Dr. Prof. Dr. Prof. Prof. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIP/MBIK-7767/2022			113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.946/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetar, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtar me Ardita Perçuku-Shyti -Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.946/2022 të datës 25.10.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë [redacted] Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit/Kuvendi i Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.946/2022, e datës 25.10.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] është i punësuar në Kuvendin e Kosovës sipas Akt emërimit të datës 10.12.2017, në pozitën "Zyrtar ndërlidhës me institucionet dhe agjencitë e pavarura", tek Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm. Me datën 25.10.2022, ka parashtruar ankesën me numër te protokollit 6441/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil te Kosovës, kundër Sekretarit te Përgjithshëm të Kuvendit të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me inicimin e procedurës për verifikimin e shkeljes së dispozitave ligjore nga ky i fundit për shkak të presionit psikologjik dhe pasojave shëndetësore, i njëjti kërkon zhdëmtimin moral dhe zhdëmtimin material për gjendjen shëndetësore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur



Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 01.11.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ndërsa, Këshilli me datën 11.11.2022, ka pranuar nga kjo e fundit përgjigjen në ankesë, së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr.prot:6441/2022 të datës 25.10.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Raportin mjekësor për ankuesin të datës 08.04.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 01.11.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 11.11.2022 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit; Akt emërimit e ankuesit te datës 10.12.2012; E-mailat zyrtar të datës 26.10.2022, 25.10.2022; Vendimin me numër Nr: SP.10-01/22 të datës 25.10.2022 nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit; Vendimin Nr: SP.7-01/22 të datës 05.07.2022 nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit; E-mailin zyrtar te datës 24.10.2022; Raportin mjekësor me numër protokolli 2022 nga Poliklinika Rezonanca në Prishtinë për ankuesin; E-mailat zyrtar te datës 24.10.2022, 17.10.2022, 20.10.2022, 18.10.2022, 06.10.2022, 05.10.2022, 14.07.2022, 13.11.2020; Raportin mjekësor te datës 05.11.2020 për ankuesin; E-mailat zyrtar të datës 06.07.2021,05.07.2022; 01.07.2022; Raportin mjekësor te datës 01.07.2021 për ankuesin; Listën e hyrje-daljeve për ankuesin për vitin 2021; E-mailat zyrtar të datës 28.04.2021; Raportet mjekësore për ankuesin të datës 21.04.2021, 07.04.2021; E-mailat zyrtar të datës 16.12.2020, 15.12.2020, 09.12.2020, 30.11.2020, 24.11.2020, 23.11.2020; Raportet e ndërprerjes së përkohshme për punë të datës 06.08.2018; 07.05.2019, 02.07.2019; E-mailin zyrtar të datës 24.02.2022.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura në lëndë të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e palejuar, *sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në vështrim të dispozitave të nenit 24 paragrafit 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, në të cilin përcaktohet se: *“Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji...”*, si dhe referuar nenit 124 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Pala ka të drejtë të ushtrojë njetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e tij juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...”*, konstaton se bazuar në pretendimet ankimore të ankuesit, të parashtruar me ankesën në Këshill, del se të njëjtit nuk i është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i cili është i përcaktuar në mënyrë specifike lidhur me marrëdhënien e tij të punës e përcaktuar sipas Aktit të Emërimit për pozitën të cilën e mban, të nënshkruar me datën 10.12.2012. Kolegji i Këshillit, pas analizimit të situatës juridike lidhur me ankesën e ankuesit, ka vlerësuar se i njëjti nuk ka arritur të siguroj dëshmi në atë drejtim, që më herët të ketë paraqitur ndonjë ankesë ndaj Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit te Kosovës, apo të inicioj tek mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i këtij të fundit veprimet ligjore lidhur me pakënaqësitë në bazë të të cilave i është cenuar ndonjë drejte apo interes i tij. Andaj bazuar në konstatimet si më lartë, Kolegji vlerëson se meqenëse në rastin konkret ankuesi me ankesën e parashtruar në Këshill nuk atakon asnjë akt administrativ, rrjedh se në mbështetje të nenit 129 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ankesa e ankuesit Fehmi Pireva është e papranueshme.





Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.946/2022.

Ardita Perçuku-Shyti



Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

